



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201502237/5

Tiranë ____/____/2015

Lënda : **Rekomandohet** *"Fillimi i hetimit të procedimit disiplinor ndaj z.I. P., me detyrë shefi i Komisarariatit të Policisë Bulqizë, për kryerje të veprimeve të paligjshme ndaj qytetarëve në mjediset e Policisë më datë 28.10.2015".*

Drejtuar : **Drejtorit të Drejtorisë së Standarteve Profesionale**
Z.Dylaver SHIMA

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

TIRANË

Për dijeni: **Drejtorit të Drejtorisë së Policisë**
Z.Edmond TARGAJ

DIBËR

I nderuar Z. SHIMA,

Rasti bën fjalë për ngjarjen e datës 28 Tetor 2015, kur nga punonjësit e Policisë së Shtetit janë shoqëruar në mjediset e Komisarariatit të Policisë Bulqizë 13 persona nga zona e Bulqizës, ndërmjet tyre dhe kryepleqtë L. D., dhe Q. S.,

Ky veprim ka ndodhur pasi më datë 27 Tetor 2015, është djegur mjeti "Warinski, i firmës "Lubima" sh.p.k, me administrator z.L. M., i cili kishte marrë lehtë shfrytëzimi për prerje të materialit drusor në zonën e Bulqizës.

Banorët e fshatrave, Koçaj, Dushaj dhe Fushë Bulqizë nuk e kanë mirëpritur këtë veprim, pasi sipas tyre nga shfrytëzimi i pyjeve në atë zonë dëmtohej uji i pishëm, uji për vaditje, me pasoja për mjedisin dhe jetën e tyre. Pasi u janë drejtuar me peticione institucioneve përkatëse vendore dhe qendrore duke parë

se prej tyre nuk gjetën zgjidhjen e kërkuar të problemit, banorët e zonës së Bulqizës kanë organizuar dhe protesta paqësore.

Mbi këtë shqetësim, Avokati i Popullit ka urdhëruar kryerjen e një hetimi të pavarur administrativ, i cili ka konsistuar në marrjen e shpjegimeve të disa shtetasve si A. B., A. B., F. Sh., etj; të kryepleqve L. D., dhe Q. S., në dhomat e sigurisë së Komisariatit të Policisë Dibër, pasi policia gjyqësore kishte kryer "Arrestin në flagrancë të tyre, si dhe ka administruar dokumente të ndryshme që disponon policia si, fletë nga libri i personave të shoqëruar apo ndaluar/arrestuar.

Rrethanat e ngjarjes

Në shpjegimet e tij datë 30.10.2015, dhënë para Ndhmëskomisionerëve të Avokatit të Popullit, shtetasi A. B., nga Koçaj i Bulqizës sqaron ndërmjet të tjerave se: *"...mua më kanë çuar në një klasë me dy kryepleqtë e fshtreve, vëllain I. dhe N. D. Ishte rreth orës 0.7.00 kur në këtë klasë ka hyrë shefi i Komisariatit. Ai ishte i nxehur dhe na tha se përse ju kanë sjellë këtu, ju e dogjët, jeni cuba dhe filloi të gjuante me grushta e shpulla duke i kapur për rrobash e përdorur forcë, shoqëruar me fjalë ofenduese. Edhe mua më qëllloi me një grusht në stomak, duke më kapur nga rrobat me të dy duart..."*.

Shtetasi F. Sh., nga Dushaj i Fushë Bulqizës, në deklaratimet e tij të datës 30 Tetor 2015, shpjegon ndërmjet të tjerave se: *"mund të ishte ora 0.7.00 , kur aty erdhi një civil që morëm vesh më vonë se ishte shefi i Komisariatit të Policisë Bulqizë. Ky person më qëllloi mua dhe personat e tjerë me grushta e shqelma nga trupi sidomos nga brinjët e krahut të majtë dhe në qafë...jam liruar nga ora 20.00 dhe kur kemi dalë nga Komisariati i Policisë aty ndodheshin 30-40 persona të tjerë, ka ardhur shefi duke përdorur fjalë fyese e duke thënë që të largoheshim. Pas 10 minutave hyra në lokalin "Relaks", që ndodhet para Komisariatit të Policisë për të pirë një kafe. Pashë që hyri shefi i Policisë i cili u ul në një tavolinë dhe bërtiste duke ofenduar...."*.

Ndërsa shtetasi Sh. A., nga Bulqiza pyetur datë 30.10.2015, deklaroi se: *"...në Komisariati më futën në një sallë në katin e parë, ku ishin dhe shtetasit N. V., Q. S., L. D., F. A., F. Sh.,...në sallë hyri shefi i Komisariatit, emrin nuk e di, i cili na shau nga nderi i familjes me fjalë poshtëruese. Ai goditi me grushte e shqelma shtetasin Feruzan Shehu..."*.

Sa i përket kryeplakut të fshatit Dushaj, L. D., pyetur datë 30.10.2015, ai shpjegon se: *"...lidhur me rastin që kemi njoftuar Avokatin e Popullit, dua të them se ngjarja është e vërtetë, pra shefi i Komisariatit të Policisë Bulqizë Ilir Proda më ka qëlluar mua dhe shokët e tjerë me grushte e shpullapër arsyet tana personale duam që ky problem të mbyllet dhe nuk duam që të ndiqet çështja nga Institucioni i Avokatit të Popullit"*.

Shtetasi Q. S., me detyrë kryeplak i fshatit Koçaj Bulqizë, në deklaratimet e tij të datës 30.10.2015, ka shpjeguar se: *"shefi i Komisariatit I. P., më ka goditur me grushte e shpulla në gjoks e fytyrë. Për arsye personale nuk dëshiroj që ky rast të ndiqet nga Institucioni i Avokatit të Popullit"*.

Konstatime dhe përfundime

Duke parë në tërësi veprimet e kryera nga shefi i Komisarariatit të Policisë Bulqizë I. P., konstatohet se prej tij ka shkelje të dispozitave ligjore dhe akteve nënligjore, të cilat konsistojnë në kapërcim të kompetencave në ushtrimin e detyrës dhe konkretisht:

Nenin 105 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” ku thuhet: *“Etika e Policisë së Shtetit përmban parimet dhe normat që rregullojnë raportet e sjelljes, qëndrimin, plotësimin të detyrave dhe komunikimit të punonjësit të Policisë për të vepruar në përputhje me ligjin, me standartet më të larta profesionale në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe në respektim të dinjitetit njerëzor të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut”.*

Nenin 133 pika 1 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” ku thuhet: *“Punonjësi i Policisë përdor forcën për të përmbushur detyrën vetëm kur kjo është e nevojshme dhe vetëm nëse të gjitha masat e tjera janë të pasuksesshme apo të pamundura”.* Me këto veprime punonjësi i policisë është përgjegjës sipas nenit 211 të “Rregullores së Policisë së Shtetit”, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.750 datë 16.09.2015, ku thuhet: *“Punonjësi është përgjegjës për përdorim të paligjshëm dhe të paarsyeshëm të forcës, nëse: 1.Përdor forcën në intesitet dhe kohë, mbi masën që është e domosdoshme për të arritur objektivin legjitim dhe të ligjshëm të Policisë”.*

Përdorimi i fjalëve fyese nga shefi i Komisarariatit të Policisë përbën shkelje të sjelljes dhe etikës në kryerjen e detyrës, e cila bie ndesh me nenin 94 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, ku thuhet: *“Punonjësi i Policisë është i detyruar të respektojë rregullat e sjelljes dhe etikës gjatë përmbushjes së detyrave”,* si dhe nenin 117 të “Rregullores të Policisë së Shtetit” që bën fjalë për Etikën e Sjelljes, ku thuhet: *“Punonjësi i Policisë gjatë kohës që është me shërbim dhe jashtë tij duhet të sillet në mënyrë të përshtatshme, me korrektesë duke respektuar dinjitetin e gjithësecilit. Nëçdo rast punonjësi i policisë i drejtohet qytetarit duke përdorur fjalët e mirësjelljes”.*

Duke respektuar detyrën fisnike dhe të vështirë të punonjësit të Policisë së Shtetit duhet të theksojmë dhe faktin se shteti ju ka dhënë atyre përgjegjësi për kryerjen e shërbimeve të policimit në respekt të plotë me shtetin ligjor. Policimi konsiderohet si manifestim i dukshëm i autoritetit shtetëror, ku ndër detyrat më të rëndësishme të saj është dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Prandaj dhe shërbimet policore duhet t'i përshtaten parimeve të demokracisë, llogari-dhënies dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

Jemi të mendimit se sjellja korrekte dhe etika profesionale e punonjësit të Policisë së Shtetit gjatë kryerjes së detyrës, jo vetëm do të minimizojë reagimin e kundërligjshëm të qytetarëve, por edhe do të rritë më tepër besimin dhe respektin ndaj tij.

Do të sugjerohet që nga ana e punonjësve të Policisë së Shtetit duhet të bëhet kujdes në ushtrimin e detyrës e cila duhet të karakterizohet nga profesionalizmi dhe sjellja etike ndaj shtetasve të ndaluar/arrestuar, në mjediset e Policisë. Oficerët e Policisë Gjyqësore të Policisë të cilët kryejnë veprimet hetimore procedurale me personat e arrestuar, duhet të tregojnë kujdesin e nevojshëm me qëllim për të mos lejuar personat e tjerë qofshin dhe titullarë të organit, të

ndërhyjnë në ushtrimin e veprimtarisë së tyre të urdhëruar nga organi i Prokurorisë.

Në hetimin e këtij rasti është mbajtur në konsideratë fakti i mosdhënies së pëlqimit nga kryepileqtë L. D., dhe Q. S., për ndjekje për veprën penale “Kryerje të veprimeve arbitrare” ndaj shefit të Komisariatit të Policisë Bulqizë, I. P.

Nga analiza e materialeve të administruara, konstohet se ka dyshime të arsyeshme dhe të bazuar se shefi i Komisariatit të Policisë Bulqizë I. P., ka kryer shkelje të rëndë të disiplinës, referuar dhe nenit 204 gërma “e” të Rregullores së Policisë së Shtetit” i cili bën fjalë: “Përdorimi i paligjshëm dhe i paarsyeshëm i forcës”, çka dhe bazuar në nenin 226 e në vijim kërkohet fillimi i hetimit të procedimit disiplinor.

Për sa sipër dhe bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë ku thuhet: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të drejtave të njeriut nga administrate publike” dhe në bazë të nenit 21 gërma “c” të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit” me ndryshimet përkatëse ku thuhet: “Avokati i Popullit pas përfundimit të hetimit, paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vënd të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen”,

REKOMANDOHET

“Fillimi i hetimit të procedimit disiplinor ndaj z.I. P., me detyrë shefi i Komisariatit të Policisë Bulqizë, për kryerje të veprimeve të paligjshme ndaj qytetarëve në mjediset e Policisë, më datë 28 Tetor 2015.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij Rekomandimi, lutemi na njoftoni brënda afatit ligjor prej 30 ditë, e parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Bashkëlidhur ju dërgojmë dokumentet e mëposhtme:

- 1.Fotokopje të proces verbaleve të marrjes së deklarimeve të shtetasve F. Sh., A. B., S. A., L. D., dhe Q. S.
- 2.Fotokopje të fletëve të rregjistrimit për personat e shoqëruar, ndaluar/arrestuar në K.P.Bulqizë dhe K.P.Dibër, muaji Tetor 2015

Duke besuar në mirëkuptimin tuaj.

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

Me porosi dhë në mungesë

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI

